



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

UDHËZUESI DHE PRIORITETET THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIMET 2026

Bashkia Durrës, mbështetur në politikat e saj për promovimin e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore, turizmit dhe zhvillimit rural, si dhe në vizionin për ta shndërruar Durrësin në një qendër të rëndësishme kulturore, turistike dhe komunitare, shpall Thirrjen nr. 2 për projekt-propozime për vitin 2026.

Kjo thirrje zhvillohet nga Bashkia Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Drejtorinë e Turizmit dhe Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile me qëllim mbështetjen e organizimit të aktiviteteve që promovojnë turizmin, kulturën, trashëgiminë, gastronominë, produktet vendase dhe identitetin lokal të territorit.

Aplikuesit mund të paraqesin projekt-propozime për një aktivitet të vetëm, për disa aktivitete, ose për të gjithë kalendarin e parashikuar në këtë thirrje. Bashkia Durrës rezervon të drejtën të përzgjedhë një ose disa subjekte fituese, sipas cilësisë së propozimeve, kapaciteteve organizative, përshtatshmërisë me aktivitetin përkatës dhe fondit të miratuar në dispozicion.

Fondi limit për këtë thirrje është 3,000,000 lekë

1. Kush mund të aplikojë?

Thirrja është e hapur për:

- persona juridikë të regjistruar si organizata jofitimprurëse;
- fondacione dhe shoqata me objekt veprimtarie në fushën e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore, turizmit, zhvillimit komunitar, zhvillimit rural apo promovimit të territorit;
- individë ose persona fizikë të regjistruar në QKB, me objekt veprimtarie të lidhur me organizimin e eventeve, promovimin e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore, turizmit dhe produkteve lokale.

Aplikuesit duhet të kenë kapacitete organizative dhe eksperiencë të provueshme në organizimin e aktiviteteve publike, kulturore, artistike, turistike, agro-ushqimore ose promovuese.

2. Aktivitetet objekt i thirrjes

Të gjitha projekt-propozimet që do të paraqiten në kuadër të thirrjes së dytë, mund të propozojnë organizimin e plotë ose të pjesshëm të aktiviteteve kulturore dhe/apo artistike të ndara në dy kategori, si më poshtë vijon:

A. Eventi Mbrëmje Gala “Durrës Tourism Awards 2026”

- **Data:** 15 shtator 2026
- **Vendi:** Amfiteatri i Durrësit

Eventi Mbrëmje Gala, e cila do të organizohet **në mbyllje të sezonit turistik veror 2026** konceptohet si një aktivitet ceremonial, artistik dhe promovues, në formën e një spektakli përmbyllës të sezonit turistik veror 2026. Eventu duhet të ndërthurë performanca artistike, muzikë, elementë vizualë, materiale promovuese për Durrësin dhe momente ceremoniale të ndarjes së çmimeve/mirënjohjeje për aktorët lokal që kanë kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

Mbrëmja duhet të ketë karakter institucional, festiv, promovues dhe vlerësues, pa natyrë gare apo konkursi. Qëllimi është shprehja e mirënjohjes publike për kontributin e bizneseve, operatorëve turistikë, strukturave akomoduese, restoranteve, agjencive turistike, guidave, agroturizmeve dhe aktorëve të tjerë që kanë ndikuar pozitivisht në imazhin turistik të Bashkisë Durrës.

Projekt-propozimi për këtë aktivitet duhet të përfshijë:

- konceptin artistik dhe institucional të mbrëmjes;
- skenarin e aktivitetit dhe programin artistik;
- mënyrën e organizimit të momenteve të mirënjohjes;
- përfshirjen e aktorëve të sektorit të turizmit;
- planin e komunikimit dhe promovimit;
- propozimin për skenografinë, zërin, ndriçimin, dekorin dhe elementët vizualë;
- masat organizative për protokollin, pritjen e të ftuarve dhe mbarëvajtjen e aktivitetit;
- buxhetin e detajuar sipas zërave.

B. Fshati n’Festë - “Traditë, Shije dhe Takim mes Brezash”

Ky kalendar synon organizimin e festave kulturore, turistike, gastronomike dhe agro-ushqimore në njësitë administrative rurale të Bashkisë Durrës, me fokus promovimin e trashëgimisë, folklorit, artizanatit, produkteve tipike lokale, gastronomisë tradicionale, zhvillimit rural dhe bashkëpunimit ndërmjet brezave.

Aktivitetet duhet të përfshijnë komunitetin lokal, fermerët, prodhuesit vendas, agropërpunuesit, artizanët, grupet artistike, shkollat, të rinjtë, bizneset lokale dhe partnerë të tjerë të territorit.

Eventi I – Njësia Administrative Rrashbull

- **Data:** 13 Gusht
- **Vendi:** Shën Vlash ose Xhafzotaj

Eventi do të promovojë traditat kulturore të zonës së Rrashbullit, historinë, bujqësinë dhe lidhjen e saj me qytetin e Durrësit. Aktiviteti duhet të përfshijë panair agro-ushqimor me produkte vendase, gatime tradicionale, program artistik, grupe folklorike, artistë lokalë dhe aktivitete për fëmijë.

Eventi II – Njësia Administrative Ishëm

- **Data:** 17 Gusht
- **Vendi:** Kalaja e Ishmit

Aktiviteti do të zhvillohet pranë Kalasë së Ishmit dhe duhet të promovojë trashëgiminë historike, peizazhin natyror, produktet vendase dhe potencialin turistik të zonës. Programi mund të përfshijë ekspozitë fotografie historike, panair artizanal, degustime, muzikë folklorike dhe promovim të plazheve, natyrës dhe agroturizmeve të zonës.

Eventi III – Njësia Administrative Manëz

- **Data:** 21 Gusht
- **Vendi:** Pllatet e Reja ose Huqi Agroturizëm

Fokusi i këtij eventi do të jetë zhvillimi rural, agroturizmi, produktet vendase dhe ekonomia lokale. Aktiviteti mund të përfshijë prezantim të produkteve bio, verës, vajit të ullirit, produkteve blegtorale, gatimeve tradicionale, artizanatit, demonstrime kulinarie dhe aktivitete për familjet.

Eventi IV – Njësia Administrative Sukth

- **Data:** 30 Gusht
- **Vendi:** Sheshi Vadardh

Ky aktivitet do të promovojë fermerët, bizneset lokale dhe traditën bujqësore të zonës. Programi mund të përfshijë panair bujqësor, ekspozim të produkteve vendase, promovim të zejeve, panair gastronomik, valle popullore dhe koncert festiv.

Eventi V – Njësia Administrative Katund i Ri

- **Data:** 4 Shtator
- **Vendi:** Manëz

Përshkrimi

Ky event do të shërbejë si aktivitet përmbyllës i kalendarit të festave lokale, duke promovuar produktet vendase, traditën, artizanatin dhe pjesëmarrjen komunitare. Aktiviteti mund të përfshijë panair agro-ushqimor, ekspozita artizanale, aktivitete sportive, aktivitete për fëmijë dhe koncert festiv.

4. Kriteret orientuese të vlerësimit

Projekt-propozimet do të vlerësohen mbi bazën e:

- përputhshmërisë me qëllimin dhe prioritetet e thirrjes;
- cilësisë dhe qartësisë së konceptit;
- kapaciteteve organizative të aplikuesit;
- eksperiencës në aktivitete të ngjashme;
- përfshirjes së komunitetit dhe aktorëve lokalë;
- ndikimit në promovimin e turizmit, kulturës, trashëgimisë dhe produkteve vendase;
- realizueshmërisë teknike dhe financiare;
- qartësisë së buxhetit;
- planit të komunikimit dhe vizibilitetit;
- mundësisë për ta kthyer aktivitetin në traditë të përvitshme.

Këshilli Kulturor mund të vlerësojë propozimet në mënyrë të ndarë sipas eventeve. Një aplikues mund të përzgjidhet për një ose disa evente, ndërsa evente të tjera mund t'u akordohen subjekteve të ndryshme.

5. Afatet kohore dhe periudha e realizimit

Afati i aplikimit: deri më datë **20 Korrik 2026**.

Periudha e realizimit të aktiviteteve: nga data **10 Gusht 2026** deri më **30 Shtator 2026**, sipas kalendarit të aktiviteteve dhe marrëveshjeve që do të lidhen me subjektin ose subjektet fituese.

6. Mënyra e aplikimit

Dokumentacioni dorëzohet në formë të printuar pranë Zyrës së Informacionit të Bashkisë Durrës, në adresën: Lagjja nr. 1, Sheshi “Liria”, Durrës.

Dokumentacioni mund të dorëzohet edhe elektronikisht në adresën:

info@durres.gov.al

Subjekti i aplikimit duhet të jetë:

“Aplikim për Thirrjen nr. 2 për projekt-propozime 2026”

7. Vizibiliteti dhe raportimi

Projektet e mbështetura duhet të evidentojnë në çdo rast përkrahjen financiare të Bashkisë Durrës dhe të përfshijnë logon e saj në materialet promovuese, vizuale, digjitale dhe mediatike.

Subjektet fituese duhet të koordinojnë paraprakisht me Bashkinë Durrës çdo material promociional ku përdoret emri, logoja ose identiteti vizual i Bashkisë.

Pas përfundimit të aktivitetit, subjektet fituese duhet të dorëzojnë raport përmbledhës, dokumentim fotografik dhe/ose video, materiale promovuese të përdorura dhe dokumentacion financiar justifikues, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen përkatëse.

Bashkia Durrës fton organizatat, subjektet kulturore, operatorët artistikë, aktorët e turizmit, zhvillimit rural dhe komunitetit të paraqesin propozime cilësore, kreative dhe të realizueshme, në funksion të krijimit të një kalendarit aktiviteteve që promovon traditën dhe vlerat historike, identitetin lokal, potencialin gastronomik, turizmin dhe imazhin e qytetit të Durrësit.